



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

DHE MBROJTJES SOCIALE
QËNDRA KOMBËTARE E CILËSISË, SIGURISË DHE AKREDITIMIT TË
INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

Nr. 44/2 Prot.

Tiranë, më 28/06/2021

URDHËR
Nr. 20, Datë 28/06/2021

MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË RISHIKUAR PËR QKCSAISH DHE
EMËRIMIN E PERSONIT PËRGJEGJËS PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT INSTITUCIONAL
TË TRANSPARENCË

Në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, VKM Nr. 230, datë 15.04.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Cilësisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore”, Urdhrit të Kryemistrit Nr. 54, Dt. 31.3.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Kombëtare të Cilësisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore” me shkresë nr. Prot. 1989/1, dt. 31.03.2016 si dhe të shkresës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr. Prot.274/9, Dt. 05.02.2021 me Lënda “Dërgohet Programi i Model i transparencës i Rishikuar” dhe “Rregjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar”

URDHËROJ

1. Miratimin e Programit të Trasparencës për Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, sipas formës dhe përmbajtjes së miratuar me urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e programit të trasparencës të rishikuar”
2. Caktimin e Znj. Rozarta Nezaj – Përgjegjëse e Sektorit të Cilësisë, Sigurisë, Menaxhimit të Rreziqeve dhe të Drejtave të Pacientëve, person përgjegjës për zbatimin e programit institucional të trasparencës, për Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, sipas Urdhrit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e programit të trasparencës të rishikuar”.
3. Programi i Trasparencës për Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore ka përmbajtje siç është publikuar ne faqen zyrtare www.qkcsaish.gov.al
4. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Akreditimit, Sektori i Cilësisë, Sigurisë, Menaxhimit të Rreziqeve dhe të Drejtave të Pacientëve, Sektori i UPK-PPK dhe EBM dhe Kordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale për të bashkërenduar punën për bërjen publike sa herë që është e domosdoshme të çdo dokumenti në funksion të programimit të trasparencës.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR
MIRELA ÇELA

